

**PERMBLEDHJE JOTKNIKE E RAPORTIT
TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
PER AKTIVITETIN:
"PERPUNIMI PESHQVE PER KONSERVIM
DHE MAGAZINIMI FRIGORIFERIK I
KONSERVAVE TE PESHKUT"**

Vendodhja : Njesia Administrative Xhafzotaj,
Bashkia Shijak, Qarku Durrës.

Kërkues: Subjekti: "Kilic Aquaculture
Albania " Sh.a.

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANagements CONSULTANTS" Sh.p.k


Altin Ahmeti

(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Administrato
Elidiana Shehu


Ing. Elidiana Shehu

(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Tetor, 2015

TABELA PERMBLEDHESE

1	TE PERGJITHSHME	2
1.1	HYRJE.....	2
1.2	TE DHENA TE PERGJITHSHME.....	3
2	PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	4
2.1.	TE PERGJITHSHME.....	4
3	PERSHKRIM I PROJEKTIT	9
3.1.	QELLIMI I PROJEKTIT.....	9
3.2.	TE DHENA TEKNIKE TE AKTIVITETIT	9
3.3.	SUBJEKTI KERRKUES.....	11
4	PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT	15
5	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS	17
5.1.	NDIKIME TE RENDESISHME GJATE FUNKSIONIMIT	17
5.1.1.	Shkarkime ne uje	17
5.1.2.	Emetimet ne ajer	17
5.1.3.	Zhurmat dhe vibrimet.....	17
5.1.4.	Ndikimi ne toke	17
5.1.5.	Ndikimi ne flore/faune	17
5.1.6.	Mbetjet e prodhuara.....	18
6	MASAT KRYESORE LEHTESUESE	18
6.1.	MASAT LEHTESUESE QE DO TE NDERMERREN GJATE SHFRYTEZIMIT TE OBJEKTIT.	18
7	PROGRAMI MONITORIMIT	20
7.1.	SKEMA E MONITORIMIT TE TREGUESVE MJEDISOR.....	20
8.1.	KONKLUZIONE.....	21
8.2.	REKOMANDIME PER INVESTITORIN	21

1 TE PERGJITHSHME

1.1 Hyrje

Vendi yne gjate viteve te fundit ka miratuar nje sere ligjesh dhe vendimesh te Keshillit te ministrave ne fushen e mbrojtjes se mjedisit, duke permiresuar ndjeshem legjislacionin mjedisor dhe social ekonomik te vendit. Gjithashtu gjate kesaj periudhe Shqiperia ka nenshkruar edhe nje sere konventash dhe protokolleesh ne klimen e permiresimit te cilesise mjedisore ne vend dhe rajon. Disa prej ketyre konventave te nenshkruara jane:

- Konventa e Aarhus per akses ne informacion, pjesemarrje te publikut ne vendim marrje ambjentaliste dhe akses te drejtesise ne ceshtjet ambjentaliste, te ratifikuar me Ligjin Nr. 8672, date 26 tetor 2000,
- Konventën e Rio De Janeiro-s per Biodiversitetin, te ratifikuar me 10 Nentor 1996,
- Konventa per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar ESPOO, Finlandë, me 25 shkurt 1991
- Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha, Gjenevë, Zvicër, me 13 nëntor 1979.
- Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës Ne Bernë, 19 shtator 1979. Etj.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) duke u bazuar ne zhvillim strategjik te zones se Durresit perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit te projektit ne kete zone. Ky raport i VNM-se po pergatitet me kerkese te Shoqerise “Kilic Aquaculture Albania” Sh.a. Projekti eshte realizuar per strukturen “Perpunimi i Peshqve per Konservim dhe Magazinimi Frigoriferik i Konservave te Peshkut” e ndodhur ne Njesine Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, Qarku Durres, me zone Kadastrale Nr.3852, Numer Pasurie 297/53.

Ne kete Vleresim do te paraqesim gjendjen, ndikimin e ketij aktiviteti mbi mjedisin e zones dhe mbi njerezit (qofshin banore te zones perreth, punonjes apo vizitor). Gjithashtu do te shqyrtojme faktoret pozitiv dhe negativ mjedisor.

1.2 Te dhena te pergjithshme

KILIC AQUACULTURE ALBANIA” sh.a i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me Numer Identifikimi te Personit te Tatueshem: L43403601A me seline kryesore ne Qarkun Tirane ,Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ismail Qemali, Pallati Fratari nr.27, Kati 4, Apartamenti 20, me perfaqesues Z. Taner Seker dhe Z. Hayri Deniz, Ne funksion te aktivitetit te tyre per rritjen intensive te peshkut, do pajisen me leje te tipit B Sipas Ligjit 10448date 14.07.2011” Per lejet e Mjedisit ”Perpunimi i Peshqve per Konservim dhe Magazinimi Frigoriferik i Konservave te Peshkut”

Ortofoto e vendodhjes



2 PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

2.1. Te pergjithshme

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Por sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative ne mjedis dhe shendet te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovojë zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM-se ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje dokument kyç per vendimarrjen per miratimin e nje zhvillimi te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori. Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar. Qellimi afatgjate i VNM eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezëve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

1. Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
2. Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;

3. Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
4. Lehtëson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit te propozuar.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise kerkohet: “Mirembajtje e nje mjedisi teper te shendetshem dhe ekologjik per brezat e tanishem dhe te ardhshem”. Kjo, por edhe opinioni i gjithe shoqerise i shprehur nepermejt ligjeve te tjera, detyron marrjen e masave imediate per rehabilitimin e mjedisit te degraduar gjate “epokes se industrializimit socialist” dhe ruajtjen e tij nga aktivitetet e sotme prodhuese, perpunuese apo ndertuese qe gjithashtu mund te shkaktojne demtime te mjedisit. Legjislacioni ne lidhje me ruajtjen e mjedisit eshte ne perputhje me normativat Europiane te mbrojtjes se tij ndonese cilesia mjedisore eshte ende ne parametra mjaft te ulet, kjo edhe ne krahasim me vendet e tjera Europiane.

Ligji i pare per mbrojtjen mjedisore daton ne vitin 1993 dhe shprehet se: “Te gjitha veprimtarite e personave fizike dhe ligjore, vendas apo te huaj, qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise, do ti nenshtrohen vlersimeve mjedisore”. Me tej, Ligji Nr. 8934, mbi mbrojtjen mjedisore percakton se : “Mbrojtja e mjedisit eshte detyrim i te gjithe shtetasve dhe individeve me veprimtari ne Shqiperi”

Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteteve te ndryshme te cilat mund te kene potencial ndotes ne mjedis.

Sipas Ligjit Nr. 10431, date 09.06.2011 Per mbrojtjen e mjedisit, me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimet e mbrojtjes së mjedisit

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake

- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrojtjen e integruar te përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e Perberesve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

2.2. Legjislacioni

Sa me siper, Permbledhja e raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim njoftimin e publikut per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri: “Ligji Per mbrojtjen e mjedisit” dhe “Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.

Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit European per mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky raport hartohet bazuar ne kerkesat e Njesive administrative te Qeverisjes Vendore per realizimin e Konsultimit me publikun per aktivitetin “Perpunimi i Peshqve per Konservim dhe Magazinimi Frigoriferik i Konservave te Peshkut”

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

- VNM e permbledhur.
- VNM i Thelluar.

Aktiviteti ne vleresim, ne baze te klasifikimit te tij si aktivitet me ndikim te vogel ne mjedis, klasifikohet si raport i permbledhur i VNM.

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te vecante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder ligjet me specifike qe kane lidhje te drejtperdrejte me projektin ne vleresim, mund te permendim:

- Ne ligjin Nr. 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” theksohet ne kapitullin V (VNM) neni 25 se:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

- Ne Ligjin Nr.10 440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” ne kreun II, neni 7 per “Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis” thuhet:

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së dhe licencimi, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis perfshin indentifikimin, sakesimin dhe vleresimin e drejtperdrejte dhe te terthorte te projektit ne mjedisin ku do te zbatohet, si dhe percaktimi i masave per te parandaluar dhe zbutur demtimet ne mjedis qe ne fazen fillestare te tij.

2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor

Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) i kushtetutes shkruhet se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotesimin e nismes dhe te pergjegjesise private, synon:

Neni d): nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Sipas Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Mjedisit eshte autoriteti pergjegjes per rishikimin e dokumentit VNM te pergatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrise se mjedisit.

Pervec Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikes se Shqiperise miratoi edhe Ligjin Nr. 10440 Date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”. Ky ligj eshte zhvilluar dhe bazuar ne Direktivat e EU dhe praktikat nderkombetare te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë:

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis”**
- **Ligji Nr 8652 Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore, dt 31.07.2000.**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”**
- **Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 “Per planifikimin e territorit”**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.**
- **Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të Mjedisit”**
- **Vendimi Nr.247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”.**
- **Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”.**
- **Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”**
- **Vendim Nr. 16, date 14.01.2012 “Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor”**
- **Vendim Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”**
- **Vendim Nr 686 date 29.07.2015 “Per miratimin e rregullave te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis dhe procedures se Transferimit te Vendimit e Deklarates Mjedisore”**
- **Udhezim Nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen ministria e mjedisit për procesin e vnm-së”**

2.4. Metodologjia

Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik dhe juridik. Ky raport vleresimi pergatitet me kerkese te investitorit. U kryen inspektive

ne terren per te konstatuar vendodhjen, karakteristikat territoriale te kesaj zone, gjendja e faktoreve te mjedisit, si dhe per te terhequr mendimin e komunitetit te zones dhe zhvillimin e aktivitetit.

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit per procedurat shqiptare te VNM-se

Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar	Procedura qe Duhet Ndjekur (Duke plotesuar Standartet Shqiptare)
Aneksi i Ligjit 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit” (Lista e veprimtarive te cilat duhet te paisen me Leje Mjedisi te tipit A, B ose C)	Ky aktivitet klasifikohet per paisje me leje mjedisore ne tipit B Pika 7.7/f “Trajtim ose Magazinim i Peshqve te ngordhur ose mbetjeve te peshqve” dhe pika 7.7/o ‘Magazinimi Frigoriferik i produkteve ushqimore te ambalazuara”

3 PERSHKRIM I PROJEKTIT

3.1. Qellimi i projektit

Projekti ne vleresim ka si qellim funksionimin e aktivitetit “Perpunimi peshqve per konservim dhe magazinimi frigoriferik i konservave te peshkut” e ndodhur ne Njesine Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, Qarku Durres. Me zone Kadastrale Nr.3852 dhe Nr pasurie 297/53.

Ky aktivitet konsiston

3.2. Te dhena teknike te aktivitetit

Subjekti “Kilic Aquaculture Albania” sh.a me perfaqesues Z. Taner Seker dhe Z. Hayri Deniz, i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Identifikimi te Personit te Tatushem: L43403601A me seline kryesore ne Qarkun Tirane ,Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ismail Qemali, Pallati Fratari nr.27, Kati 4, Apartamenti 20,, do te zhvilloj aktivitetin: “Perpunimi peshqve per konservim dhe magazinimi frigoriferik i konservave te peshkut”, e ndodhur ne Njesine Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, Qarku Durres .

Truallit ku do te zhvillohet ky aktiviteti eshte ne pronesi te vete shoqerise “Kilic Aquaculture Albania” sh.a. me siperfaqe 6012 m², adresa e pasurise Xhafzotaj, Durres, Zona kadastrale 3852 dhe Nr pasurie 297/53, lloji i tokes eshte are + truall.

Objekti ka keto te dhena urbanistike:

Siperfaqja e parces	6012 m²
Siperfaqe Trualli	4990 m²

Ky aktivitet do sherbeje per perpunimin dhe paketimin e peshkut ne perputhje me standardet kombetare dhe nderkombetare te sigurise ushqimore

Per Produktet e “Kilic Aquaculture Albania” do te behet kontroll i vazhdueshëm nga ekspertë/ inxhinierë të kualifikuar te akuakulturës per cdo faze te prodhimit dhe nenshtrimit te shum analizave per cilesine dhe higjenen e ketij produkti.

Subjekti do kujdeset per mirefunksionimin e ketij aktiviteti, per cilesine e peshkut, per menyren e perpunimit te tij, per higjenen e produktit , ambalazhimin dhe konservimin me makineri te sofistikuara, sipas kerkesave te klientit.

Prudukti i peshkut i kultivuar ne Shqiperi nga subjekti “Kilic Aquaculture Albania”, do perpunohet dhe konservohet ne vendin tone dhe produkti final do tregtohet jashte vendit.

Foto nga aktiviteti i Shoqerise “Kilic Aquaculture Albania”





3.3. Subjekti kerkues

Subjekti “Kilic Aquaculture Albania” sh.a me perfaqesues Z. Taner Seker dhe Z. Hayri Deniz, i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Identifikimi te Personit te Tatueshem: L43403601A me seline kryesore ne Qarkun Tirane ,Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ismail Qemali, Pallati Fratari nr.27, Kati 4, Apartamenti 20,, do te zhvilloj aktivitetin: “Perpunimi peshqve per konservim dhe magazinimi frigoriferik i konservave te peshkut”, e ndodhur ne Njesine Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, Qarku Durres .

Objekti i aktivitetit eshte: Ndertimi, perdorimi, marrja e dhenia me qera, blerja dhe shitja e stallave, pularive, fermave dhe te gjitha aktivitetet ku mundesohet kultivimi dhe rritja e 9do lloj bagetie te imet, te gjedhit, te shpendeve te pularise si dhe te produkteve te peshkimit. Themelimi, marja e dhenja me qera, blerja dhe shitja si edhe ushtrimi i cdo aktiviteti qe lidhet me kombinatet mishi, bulmetore, thertore, fabrika dhe dhoma me ajer te ftohte per perpunimin e produkteve te kafsheve te kultivuara, prodhimin e cdo lloj produkti te marre nga kafshet dhe prodhime bujqesore si dhe eksportimin dhe importimin e tyre, shitjen me shumice ose pakice. Prodhimin e grumbullimin me shumice dhe pakice te te gjitha produkteve ushqimore te mishit, qumeshtit dhe peshkimit nga kafshet qe rrit vete ose te marra nga persona te trete. hapjen e filjaleve, dyqaneve, supermarketeve apo hipermakete per produktet e peshkimit qe jane te fresketa dhe te sapo perpunuara e te ftohura, perpunimin, shperndarjen dhe marketingun e tyre, kryerjen e sherbimeve te shitjes e blerjes si dhe import eksportin e tyre. Ndertimin e te gjitha objekteve te medha ose te vogla si fabrika, punishte, pika shitjeje, depo dhe objekte te tjera qe kane lidhje me objektin e aktivitetit, dhenia ose marrja me qera, perdorimi, blerja dhe shitja me shumice ose pakice e makinerive te nevojshme per to si dhe importimi e eksportimi i tyre, Ndertimi i fabrikave per prodhimin e fdo lloj produkti ushqimor per kafshet, hapjen e objekteve te nevojshme per prodhimin e produkteve si dhe te nenprodukteve te tjera te nevojshme per rritjen e blegtorise, tregetimin me shumice dhe pakice te ketyre produkteve si dhe kryerjen e eksportit e importit te tyre. Kultivimi i 9do lloj prodhimi bujqesor te nevojshem per te ushtruar aktivitetin, kultivimi i bimeve qe jane lende e pare ose mundesimin e kultivimit te tyre nga personat e trete me ane te marreveshjeve, korrjen e tyre, blerjen, shitjen ose marjen dhe dhenien me qera te arave, sigurimin brenda osheshte vendit te cdo lloj nevoje per kryerjen e kultivimit dhe korrjes. Shitjen, blerjen importimin dhe eksportimin e te gjitha mjeteve te nevojshme per kryerjen e aktivitetit si traktor, makineri transporti, meje te komunikimi, makineri pune, te gjitha veglat dhe produktet e nevojshme per kryerjen e kultivimit bujqesor, blerja e pjeseve te kembimit te makinerive e lendeve te tjera te nevojshme. Themelimin e Shoqerive te reja qe kane lidhje me aktivitetin me ane te


personave fizike ose juridike vendas ose te huaj, pjesemarrjen ne Shoqeri qe jane te formuara, te organizoje sipermarje te perbashketa, te bleje aksioneve te Shoqerive qe futen ne fushen e aktivitetit me kusht te mosberjes se ndermjetesimit shitjen e tyre . Kryerjen e aktiviteteteve si marketing, organizime ekonomike, konsulenca dhe studime fizibiliteti te nevojshme dhe qe" kane lidhje me aktivitetin e Shoqerise. Te angazhohet per punet qe jane pjese e objektit te aktivitetit te saj, te transportoje, te vendose komisione, te hapi agjenci dhe te beje perfaqesime. Te bej cdo lloj kerkimi dhe zhvillimi per objektin e aktivitetit, te realizoje projekte, te perfitoje nga proceset e mbeshtetjes dhe inkurajimit. Brenda kuadrit te aktivitetit dhe te potencialit eksportues dhe te lendes se pare Turke, te organizoje brenda dhe jashte vendit ekspozita, panaire dhe orgaizime te tjera te ngjashme per te bere njohjen e produkteve gjysem te gatshme dhe te gatshme ose te marre pjese ne keto lloj organizimesh te pergatitura nga te tjeret. Per aspektet qe kane lidhje me aktivitetin te mbroje te gjitha te drejtat materiale dhe jo-materjale (si leje, license, koncesion, patente, diplome, Knoe-hoe, marke dhe kote), te drejtat e pronesise intelektuale dhe te drejtat industriale, perdorimi i tyre brenda kushteve te percaktuara, ushtrimi i se drejtes se shitjes dhe blerjes se tyre. Marrja e kredive afatgjata, afatshkurter ose me afat mesatar sipas nevojës se Shoqerise brenda dhe jashte vendit, dhenja e cdo lloj garancie sipas regullave te parashikuara ne ligjistacion, te marri teresisht pronat e luajtshme dhe te paluajtshme, t'i bleje, t'i pranoje dhe t'i veri ne perdorim te te njejtit kapital; te kryhet 9do lloj akti ligjor mbi to, t'i shese, ti ndertoje ti marre me qera, t'i japi me qera, t'i riparoje ose t'i zmadhoje ne rast se eshte e nevojshme, perdorimi i te gjitha te drejtave reale te blerjes, te nderroje dore ose te beje percaktim, lenja peng ne favor te kreditoreve, dhenja per hipoteke, marja ne hipoteke apo marja peng, te behet kerkesa e njesimit ose ndarjes se pasurise se patundshme, berjen e klasifikimit ne tipe. Shoqeria, duke u mbeshtetur ne ligji shqiptar mund te krijojë shoqata ose fushata(fonde) ndihme per personelin qe punon ne strukturen e saj ose per personat qe kontribojne ne kapital in e saj, mund te marri pjese ne drejtimin e tyre, te ofroje mundesi (fonde) qe te mundesohet egzistenca e ketyre shoqatave, kur eshte e nevojshme me qellim qe keto shoqata me angazhime sociale te forcohen dhe te vazhdojne aktivitetin e tyre Shoqeria mund te ofroje ndihme financiare. Ne rast se Shoqeria e sheh te arsyshme qe pervec aktiviteteteve te percaktuara me siper te" behen edhe aktivitete te tjera atehere ne fillim nga Bordi i Pergjithshem (ortakeve) duke patur parasysh kete nen duhet te ribej nje perpilim te ri te ketij neni dhe shtesat e nevojshme dhe pasi pranohet nga Bordi i Drejtoreve duhet te behet rregjistrimi dhe shpalja e saj.

Vendodhja e objektit

Objekti ne vleresim eshte zhvillimi i aktivitetit “*Perpunimi peshqve per konservim dhe magazinimi frigoriferik i konservave te peshkut*”

Adresa e ketij objekti eshte:Njesia Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, Qarku Durres,me Zone Kadastrale Nr.3852, Numer Pasurie 297/53.

Pamje satelitore te sheshit te propozuar per zhvillim



3.1. Lidhja e objektit me infrastrukturen Inxhinierike

Objekti ku do te zhvillohet ky aktivitet eshte pajisur me te gjithe infrastrukturen inxhinierike te nevojshme. Objekti nuk ka ndikuar ne demtimin ose devijimin e infrastruktures inxhinierike ekzistuese. Deri ne ndertimin e nje sistemi te ri kanalizimesh per te gjithe zonen e studiuar, objekti do te plotesoje nevojat e tij per uje higjeno-sanitar nepermjet shfrytezimit te rrjetit ekzistues dhe persa i perkete sistemit te shkarkimit te ujerave te zeza, do te lidhen me kanalizimet ekzistuese ne zone sic jane ato te objekteve te ndertuara me heret.

Per mbetjet e gjeneruara nga ky aktivitet subjekti do te lidhi kontrat me subjekte qe jane te licensuar per trajtimin dhe perpunimin e peshqve te ngordhur si dhe mbetjet e peshqve. Mbetjet qe do te gjenerohen nga punonjesit do te menaxhohen ne bashkepunim me njesine administrative dhe do te percaktohet vendi i depozitimit te tyre nga kjo njesi.

3.2. Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lëndëve të para

Lendet e para qe do perdoren ne kete aktivitet jane peshqit Koc dhe levrek te cilet kultivohen nga vete kompania “Kilic Aquaculture Albania” sh.a ne Shkoder.

3.3. Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet ne mjedis gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti do te jene ne zhurma per arsye te shtimit te trafikut ne kete zone, nga aktiviteti human do te kete shkarkime te ujerave te zeza, te cilat kane cilesine e ujerave urbane si ne te gjitha zonat e tjera te banuara. Keto shkarkime do te kryhen ne sisemin ekzistues te kanalizimeve te zones, kjo deri ne investimin e Bashkise per nje sistem te ri kanalizimesh per te gjithe zonen e re te zhvillimit per te plotesuar kapacitetet e zhvillimeve te tjera ne zone.

Mbetjet qe do te gjenerohen nga funksionimi i ketij aktiviteti do te jene peshq te ngordhur, si dhe mbetje te peshqve qe dalin gjate pastrimit dhe paketimit te tij, per te cilat subjekti do te lidhi kontrat me subjekt te licensuar per trajtimin e ketyre mbetjeve

4 PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

Zona Gjeografike:

Shijaku kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga bashkia Durrës dhe në lindje nga bashkitë Vorë dhe Tiranë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut.



Popullsia:

Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 27,861 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrisë Civile kjo bashki numëron 44,103 banorë. Me sipërfaqe prej 92.19 km², ajo ka densitet prej 302 banorë/km² sipas censurit dhe 478 banorë/km² sipas regjistrisë civile.

Bashkia e re përbëhet nga katër njësi administrative të cilat janë Shijaku, Maminasi, **Xhafzotaj** dhe Gjepalaj. Të gjitha janë pjesë e Rrethit Durrës të Qarkut Durrës. Bashkia e re ka një qytet dhe 25 fshatra.

Profili Bashkisë

Bashkia e re Shijak shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore përgjatë lumit Erzen.

Shijaku është një qytet i pasur me burime ujore, ekonomia në vend është e orientuar kryesisht te tregtia, industria fashon dhe ajo përpunuese e prodhuese. Firmat private numërohen 263 subjekte nga të cilat 17 klasifikohen si biznes i madh dhe 246 si biznes i vogël.

Këto biznese operojnë kryesisht në fushën e shërbimeve, tregtisë dhe me pak në fushën e prodhimit dhe ndërtimit.

Shijaku është një zonë që ka patur rritje të popullsisë gjatë dekadave të fundit si pasojë e migrimit nga zonat veri-lindore të Shqipërisë.

Duke parë ndryshimin e madh midis popullsisë rezidente dhe asaj prezente në regjistrat civilë vihet re se, zona është e prekur ndjeshëm nga emigracioni. Remitancat e emigrantëve kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e zonës, kryesisht në Shijak dhe Xhafzotaj.

Rritja e popullsisë si dhe emigrimi kanë sjellë shumë ndërtime të reja përgjatë 25 viteve të fundit të cilat janë ndërtuar pa një plan të mirëfilltë zhvillimor. Bujqësia është orientuar drejt produkteve me vlerë të lartë të shtuar si kultivimi i perimeve dhe foragjereve, mbarështimi i bagëtive dhe pemëtarisë. Karakteristikë e komunitetit është kultivimi i perimeve e foragjereve dhe zgjerimi gjithnjë në rritje i sipërfaqes së vreshtave, pemëtoreve dhe ullishtave, dhe në zonat kodrinore kultivimi i barbuinjës së hershme dhe i bostanoreve.

Por një pjesë e tokës bujqësore ka mbetur e papunuar ndërsa shumë toka janë të rrezikuara nga lumi Erzen, të cilit i janë marrë sakaq pjesa më e madhe zhavorrit duke hequr për rrjedhojë edhe barrierën natyrore të tokave në të dy krahët e lumit.

Legalizimi i banesave të ndërtuara pa leje është një shqetësim i vazhdueshëm i banorëve të qytetit siç është edhe transporti i dobët publik drejt Durrësit, ku një pjesë e popullsisë udhëton për të punuar.

Sfidat me të cilat do të përballlet pushteti vendor pas ndarjes së re

Hartimi i një plani zhvillimor për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm të resurseve bujqësore si dhe për të lehtësuar pajisjen me infrastrukturë të qendrave të banuara është një sfidë imediate për bashkinë e re.

Ndalimi i gërryerjes së mëtejshme të shtratit të lumit Erzen si dhe mbrojtja e tokave sakaq të rrezikuara nga erozioni përmes ndërtimit të barrierave artificiale janë një sfidë tjetër.

Shijaku ka mundësi të mira për të zhvilluar bujqësinë dhe blegtorinë duke qenë pranë tregjeve të mëdha konsumatorë si Tirana dhe Durrësi por fermerët kërkojnë më shumë industri përpunuese, pika grumbullimi dhe shpërndarjeje, thertore apo shërbime frigoriferike për të maksimizuar të ardhurat nga bujqësia.

Furnizimi me ujë të pijshëm të komunitetit, duhet të jetë prioritet për qeverisjen e re vendore në Shijak. Furnizimin me ujë të pijshëm në disa fshatra bëhet me burime natyrore ,(kroje dhe puse).Po kështu dhe kanalizimi i ujërave të zeza dhe të bardha është një tjetër sfidë për drejtuesit e pushtetit vendorë.

Mënyra më e përhapur për sistemimin e ujërave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre duke shkaktuar probleme me mjedisin. Po kështu, drejtuesit e rijë duhet të mendojnë për hartimin e projekteve për vaditjen e tokave bujqësore të fshatrave të zonës, ku thatësira shkatërron pjesën më të madhe të prodhimit të banorëve. Përpunimi i mbeturinave është një tjetër shqetësim që përballen banorët e zones

5 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE RENDESISHME NE MJEDIS

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen per fazen e funksionimit te ketij aktiviteti.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe do te implementohet do te vleresohen ne menyre te pergjitheshme nga ky raport VNM-je. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

5.1. Ndikime te rendesishme gjate funksionimit

5.1.1. Shkarkime ne uje

Ujrat qe dalin nga funksionimi i ketij aktiviteti jane ujera urbane te cilat lindin si rrjedhoje e larjes dhe pastrimit te peshkut para konservimit te tij dhe ujrave qe dalin nga aktiviteti human. Do te kemi konsumim te ujit per mirefunksionimin e ketij aktiviteti por konsumimi i tij do te perdoret me eficence nga personat pergjegjes per mirembajtjen e mjedisit te gjelberuar perreth, kjo gjate fazes se funksionimit.

5.1.2. Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer mund te vijne nga nr i automjeteve qe do shtohen ne kete zone per transportimin e peshkut dhe produktit final qe jane konservat e peshkut.

5.1.3. Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe do te prodhohen do te vijne kryesisht nga shtimi i nr te mjeteve ne kete zone per transportin e produkteve te peshkut.

5.1.4. Ndikimi ne toke

Keto procese nuk do te ndikojne negativisht ne toke, kjo vjen si rezultat se gjate funksionimit nuk jane ushtruar veprimtari qe kane lidhje me ndryshime te tokes apo dheut.

Subjekti duhet te ndertoj nje vaske dekantuese per trajtimin e ujrave qe dalin nga ky aktivitet, ujrave qe dalin nga ky aktivitet nuk duhet te shkarkohen direkte ne rrjetin e kanalizimeve te zones. Terreni i ketij objekti pervec siperfaqeve te gjelberuara do te jete i gjithi i sistemuar dhe i shtruar me beton dhe pllaka dekoruese, gje e cila e eleminon mundesine per te pasur kontakt me token.

5.1.5. Ndikimi ne flore/faune

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti i ketij objekti nuk do te ndikojne ne flore dhe faune. Siperfaqja ekzistuese eshte me bimesi barishtore, me objekt te ndertuar dhe me disa peme te mbjella artificialisht.

5.1.6. Mbetjet e prodhuara

Mbetjet te cilat do te gjenerohen nga ky aktivitet jane mbetjet e pastrimit te peshkut, si dhe peshq te ngordhur, per te cilat subjekti do lidhi kontrate me subjekt te licensuar per trajtimin e ketyre mbetjeve.

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen nga konsumi i perditshem ne kete zone do te jene mbetjet e ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre, mbetje organike, etj, te prodhuara nga punonjesit gjate funksionimit te ketij aktiviteti, keto mbetje duhet te menaxhohen ne bashkepunim me Bashkin Shijak dhe firma ricikluese te pershtatshme per keto lloj mbetjesh. Grumbullimi i mbetjeve duhet te jete i diferencuar.

6 MASAT KRYESORE LEHTESUESE

6.1. Masat lehtesuese qe do te ndermerren gjate shfrytezimit te objektit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të aksidenteve dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe do te zbatohen nga kontratuesit gjate funksionimit te aktivitetit. Ndikimet negative ne mjedis gjate shfrytezimit te zones jane ne nivele shume te ulta. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar.

Gjatë funksionimit te aktivitetit, subjekti duhet te siguroje:

- Shkarkimi brenda normave në ajër.
- Shmangie deri në minimizim të rrjedhjeve në ajër, ujë dhe tokë të shkarkimeve ndotëse për mjedisin.
- Tokëzimi i rrjetit dhe impianteve energjike.
- Menaxhimi me efikasitet i territorit.
- Në çdo periudhë të realizohen matje dhe analiza per shkarkimet e ujit te ketij aktiviteti
- Mbajtjen në gjendje shumë të mirë teknike (të pajisjeve, sistemit të ngarkim-shkarkimit, sistemit të kontrollit, makieria e larjes se peshkut etj).
- Mbetjet e krijuara nga funksionimi i ketij aktiviteti, mbetjet e peshqve subjekti duhet te lidhi kontrat me subjekt te licensuar per trajtimin e ketyre mbetjeve.

- Mbetjet e krijuara nga punonjesit ne objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia dhe të vendosen kosha të mjaftueshem për numrin e puntoreve.
- Sistemi i shkarkimit të ujerave urbane të jete i lidhur me sistemin e kanalizimeve të zones.
- Ujrat e dala nga ky aktivitet të mos derdhen në rrjetin e kanalizimeve të zones pa u trajtuar me pare, subjekti të pajiset me vaske dekantuese.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtesi të ulet në zonat e banuara.
- Ky objekt nuk do të prodhojë ndotës për mjedisin nëse merren masa për të rehabilituar dhe monitoruar vazhdimisht mjedisin e punës.
- Nuk do të ketë ndotje akustike, rrezatime apo vibrime, etj që mund të jenë të rrezikshëme për jetën e individëve dhe për mjedisin natyror. Për nevojat higjieno-sanitare, uji do të merret nga rrjeti i zones.

7 PROGRAMI MONITORIMIT

7.1. Skema e monitorimit te treguesve mjedisor.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, derdhjeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.

Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.

Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.

Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi eshte detyre e shoqerise investitore ne nivel individual per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te Vendimit Nr.1189. date 18.11.2009 Per monitorimet ne Republiken e Shqiperise

Investitori do te monitoroje keto treguese te trysnise ne mjedis te cilet jane:

Ç-1. Per ndryshimet klimaterike(a, b);- nuk do te monitorohen nga investitori sepse nuk ka ndikim kjo veprimtari ne keto tregues mjedisor ne permasa kaq te larta sa te ndikoj ne ndryshim te klimes se ketij rajoni pasi ne kete objekt nuk do te ushtrohet asnje proces industrial dhe nuk do te emetohen ndotesa industrial te gazte ne kete zone.

Ç-6. Per shkarkimet e lengeta (a, b, c);-- do te kete monitorim te ndotesave te lenget pasi do te kete veprimtari te tilla ne kete aktivitet. Monitorim do te behet vetem per shkarkime te lengeta qe do te prodhohen gjate funksionimit te ketij aktiviteti, ujrat te cilat do te perdoren per larjen e peshkut para konservimit te tij.

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet nga inspektoret e mjedisit(supervizori) gjate punimeve. Monitorimi i ujerave te gjeneruara nga ky aktivitet do te realizohet nga institucioni pasi eshte detyre e institucioneve perkatese shteterore si mund te jete ISHP(Instituti i Shendetit Publik), etj. Detyre e kontraktuesit jane lidhja e rrjetit te kanalizimeve me piken e shkarkimeve te percaktuar nga Drejtoria e Ujesjelles Kanalizimeve si dhe monitorim sezonal –jo periodik i

dekantuesit rezerve qe do te perdoret per shmangie te derdhjeve aksidentale ne mjedisin perreth.

Ç-7. Per burimin e ndotjes qe shkaktojne ne ajer;-- burimet kryesore qe shkaktojne ndotjen e ajerit gjate funksionimit te aktivitetit jane; nga shtimi i automjeteve qe do te perdoren per transportin e produktit te peshkut.

Ç-8. Sasia vjetore e kimikateve te rrezikshme te importuara.—ky projekt nuk perfshin ne asnje stad importimin e kimikateve te rrezikshme dhe toksike te asnje lloj apo te demshme per mjedisin natyror dhe njerezor.

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
1.	Monitorim i zhurmave gjate funksionimit te aktivitetit	Vazhdueshëm
2.	Monitorimi i ujrave qe gjenerohen nga aktiviteti	Vazhdueshëm

8.1. Konkluzione


Aktiviteti i propozuar, synon te ofroje ne tregun vendas nje sherbim cilesor dhe me standarte te larta e bashkekohore, per nje zhvillim ekonomik e social ne perputhje me zhvillimin e zones.

8.2. Rekomandime per investitorin

- I. Menaxhim i integruar i mbetjeve te ngurta duke i seleksionuar dhe menaxhuar nepermjet sherbimit te njesise administrative ose subjekte te licensuar per kete qellim ne marredhenie kontraktuale me njesine administrative Xhafzotaj
- II. Mbetjet e peshkut te gjeneruara nga aktiviteti te menaxhohen nga subjekt te licensuar per trajtimin e ketyre mbetjeve.
- III. Menaxhimi i ujrave te gjeneruara nga ky aktivitet te te trajtohen para se te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones
- IV. Shtrimi dhe betonimi i ambjenteve qarkulluese dhe i sistemit te kanalizimeve per orientimin e ujrave ose lendeve te tjera qe mund te gjenerohen gjate aktivitetit.
- V. Te mos hidhet asnje mbetje e ngurte ose e lenget ne mjedisin uJOR dhe ate tokesore te zones.
- VI. Te vendosen kosha per grumbullimin e mbetjeve ne nivel me te larte se kapaciteti i zones, ne menyre qe te shmanget hedhja e mbeturinave jashte konteniereve.
- VII. Lidhja e objektit per furnizimin me energji elektrike te kryhet bazuar ne nje kontrate me specialistet e operatorit te shperndarjes se energjise elektrike.

- VIII. Sigurimi i ujit per nevojat higjenosanitare te kompleksit dhe ndertim i infrastruktures inxhinierike si rruge, telefoni, kanalizime, etj ne bashkepunim me njesine administrative Xhafzotaj.
- IX. Te kryhet monitorimi i treguesve mjedisor per te shmager mbi kalim te normave te shkarkimit per punimet ndertuese dhe raporti periodik i vetemonitorimit te dorezohet ne DRM e qarkut Durres cdo tre muaj.
- X. Mirembajtja dhe gjelberimi ne menyre te vazhdueshme e mjediseve perreth objekteve duke krijuar kushte cilesore jetese per banoret.
- XI. Te zbatohen kushtet e lejes mjedisore qe do te jepet nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave
- XII. Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe te ndryshimeve te tij.

Ortofoto e zones ne vleresim



Koordinatat

Nr	X	Y
1.	375242.86	4578773.03
2.	375279.67	4578784.23
3.	375307.58	4578630.94
4.	375270.12	4578622.43